



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Vendim nr. 4

“Mbi korigjimin e vendimi nr. 143 datë 26.04.2019”

Sot në datë 15.05.2019, trupi gjykues, ora 10:00 i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Brunilda Bekteshi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, sipas të cilit përcaktohet se: “1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njëzuar të tij*”, u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Firdes Shuli, për korigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit Rexhep Bekteshi.

Në vendimin e arsyetuar nr. 143, datë 26.04.2019, për subjektin e rivlerësimit z. Rexhep Bekteshi, i cili u dërgua palëve respektive, subjektit të rivlerësimit, përfaqësuesve të ONM-së dhe Komisionerëve Publik, si dhe u publikua në faqen zyrtare të KPK, në datën 14.05.2019, u konstatua se gjatë procesit të redaktimit të vendimit, gabimisht nuk është reflektuar kapitulli III, që i përket “KONTROLLIT TË FIGURËS”.

Ky fakt është dukshëm një gabim material gjatë redaktimit të vendimit, për arsyet si vijojnë:

1. Me vendimin nr. 1, datë 22.05.2018, trupi gjykues vendosi fillimin e hetimit administrativ sipas neneit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke përfshirë të tri kriteret e vlerësimit, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.
2. Me vendimin nr. 2, datë 5.4.2019, trupi gjykues vendosi të përfundojë hetimin paraprak administrativ për të tri kriteret e vlerësimit.
3. Në kapitullin VII “Konkluzione përfundimtare”, pika 2, të vendimit numer nr. 143 datë 26.04.2019, publikuar në faqen zyrtare të KPK, në datën 14.05.2019 është reflektuar se “*lidhur me kriterin e pastërtisë të figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Rexhep*

*Bekteshi, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas germës b, të nenit 59/1, të ligjit nr.84/2016”.*

4. Në email-in e ditës së mërkurë, datë 08.05.2019, ora 04:19 e pasdites, dërguar nga relatorja e çështjes, znj. Firdes Shuli, në adresën zyrtare të redaktore znj. Valbona Xhamo, është kërkuar redaktimi i vendimit përfundimtar për subjektin e rivleresimit Rexhep Bekteshi, bashkangjitur, në arsyetimin e të cilit, është i përfshirë kapitulli III, me emertimin “KONTROLLI I FIGURËS”, i cili përmban gjithësej tre paragrafë.
5. Në emailin e ditës së premte 10.5.2019, ora 11:53 e paradites, zonja Valbona Xhamo, ka nisur vendimin e redaktuar, në të cilin mungon kapitulli III.

Nga të gjitha sa më sipër, duket qartazi që, mospërfshirja e kapitullit III, “KONTROLLI I FIGURËS”, në vendimin nr. 143 datë 26.04.2019, publikuar në faqen zyrtare të KPK-së, në datën 14.05.2019, është një pasaktësi e dukshme, e bërë nga pakujdesia, gjatë procesit të redaktimit të vendimit.

Për këtë arsye, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në nenin 112 të Kodin e Procedurave Administrative, ku citohet se, “*organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ*”, trupi gjykues çmon të bëjë korrigjimin e këtij gabimi në vendim, në përfundim të faqes 11 dhe para kapitullit IV “VLERËSIMI PROFESIONAL”, duke shtuar kapitullin III, që i përket “KONTROLLIT TË FIGURËS”, si vijon :


### **“III. KONTROLLI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) me shkresën nr. 12321 prot., datë 02.11.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Hasan Bekteshi, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. 3554, datë 26.12.2018, i cili në përfundim, ka konkluduar se:

- Formulari i deklarimit është i plotë i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me ligjin nr. 84/2016.
- Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Gjatë hetimit administrativ, pas verifikimeve, është konstatuar plotësimi me saktësi i formularit për kontrollin e figurës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, nuk ka pasur të dhëna, informacione dhe dyshime për kontakte te papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo veprimtari korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit”.

Për sa më sipër, trupi gjykues, pasi konstatoi se kërkesa e relatores është e bazuar dhe pasaktësia është dukshme si pasojë e një gabimi gjatë redaktimit të vendimit,



## V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 143 datë 26.04.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përfundim të faqes 11 dhe para kapitullit IV “VLERËSIMI PROFESIONAL”, të shtohet kapitulli III, “KONTROLLI I FIGURËS”, si vijon:

### “III. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) me shkresën nr. 12321 prot., datë 02.11.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Rexhep Hasan Bekteshi, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. 3554, datë 26.12.2018, i cili në përfundim, ka konkluduar se:

- Formulari i deklaramentit është i plotë i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

- Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Gjatë hetimit administrativ, pas verifikimeve, është konstatuar plotësimi me saktësi i formularit për kontrollin e figurës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, nuk ka pasur të dhëna, informacione dhe dyshime për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo veprimtari korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit”.

2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.

3. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### Trupi Gjykses

<b>Roland Ilia</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Brunilda Bekteshi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>



Sekretare gjyqësore  
Anisa Duka

